**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I**
**S Ë BASHKIA KAVAJË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Kavajë më 16.01.2025

# <u>RAPORT</u>

## PËR PUNËN KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT 2024

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efiçencë dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Kavajë mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli si më poshtë:

1. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"
3. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
4. Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetë-Qeverisjen Vendore"
5. Ligji nr. 44, datë 30.4.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative"
6. Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"
7. Ligji nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"
8. Ligji nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit"
9. ~~Ligji nr. 146, datë 301.10.2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"~~
10. Ligji nr. 68, datë 27.04. 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
11. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menazhximin e sistemit buxhetor në

Republikën e Shqipërisë"

12. Ligji nr. 9970, datë 24.70.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"
13. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
14. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"
15. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave",i ndryshuar
16. Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"
17. Ligji nr. 138, datë 17.12. 2015 "Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike". 19. Ligji nr. 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", i ndryshuar.
18. Rregullore e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Kavajë, me Vendim nr.93, datë 21.08.2020.
19. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të Këshillitarit Bashkiak", me Vendim nr.93, datë 21.08.2020.
20. Rregullore për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median, me Vendim nr.99, datë 25.09.2020
21. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare, me Vendim nr.93, datë 21.08.2020.
22. Rregullore për miratimin e Strukturave Komunitare dhe Ndërveprimi I tyre me Këshillin Bashkiak, me vendim nr.120, datë 19.11.2020.

Këshilli i Bashkisë Kavajë, gjatë 12-mujorit të vitit 2024 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit. Shqyrtimi dhe miratimi më i madh i vendimeve i kushtoheshin proçesit të rindërtimit pas tërmetit të datës 26.11.2019, por gjithashtu ka marrë dhe vendime, që i kushtoheshin familjeve me probleme të thella sociale te shkaktuara nga termeti.

Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Kavajë si më poshtë :

| **Nr.** | **Muaji** | **Ndihmë ekonomike për familje *nga të ardhurat e Bashkisë*** | **Ndihmë ekonomike për familje *nga fondi i kushtëzuar 6 %*** |
|---|---|---|---|
| 1. | Janar | 87 | 2 |
| 2. | Shkurt | 91 | 9 |
| 3. | Mars | 91 | 12 |
| 4. | Prill | 93 | 17 |
| 5. | Maj | 91 | 19 |
| 6. | Qershor | 87 | 19 |
| 7. | Korrik | 86 | 19 |
| 8. | Gusht | 89 | 18 |
| 9. | Shtator | 91 | 18 |
| 10. | Tetor | 94 | 20 |
| 11. | Nëntor | 94 | 22 |
| 12. | Dhjetor | 90 | 23 |

Kemi akorduar bonus strehimi për familjet që përmbushnin kriteret ligjore për të përfituar këtë bonus të akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise në favor të Bashkisë

Kavajë, me VKB.

*Në zbatim të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 Këshilli i Bashkisë Kavajë, ka marrë vendime të rëndësishme për periudhën janar - dhjetor 2024 si,*

1. Per shembjen e detyruar.miratimin e listes se familjeve qe perfitojne nga programi I granteve te rindertimit.shtese e vkb nr.88 date 11.11.2021,ndryshimin e mases se perfitimit ne vkb nr,4.date 20.01.2023
2. Per miratimin e shembjes se detyruar te objektit pallat n.151, nerrugen Josif Budo, miratimin e listes se familjeve qe perfitojne apartament banimi nga programi I granteve te rindertimit.
3. Miratimi I listes familjeve qe kalojne ne strehim apartamente per te permbyllut procesin e rindertimit per familjet e prekura ne ish-Fabrika e Letres.
4. Per miratimin e perfituesve ne programin e rindertimit per kategorine e banesave individuale dhe shembjes se detyruar nga termeti I dates 26.11.2019
5. Per miratimin e subjekteve perfituese per nivelet DS1, DS2, DS3 te objekteve te demtuara nga termeti I dates 26.11.2019
6. Mbi nje ndryshim te VKB nr88 dt.11.11.2021, duke shtuar listen e ketij vendimi si perfitues

*Krahas këtyre vendimeve të mësipërme kemi miratuar vendime për :*

- Per dhenien e bllok ndihmes ekonomike deri ne 6% per familjet ne nevoje per muajin Dhjetor 2023 dhe miratimin e familjeve aplikuese qe perfitojne nga programi I bllok ndihmes ekonomike deri ne 6%, nga fondi I kushtezuar dhe buxheti I bashkie Kavaje.
- Per percaktimin e kritereve per dhenien e ndihmes ekonomike per familjet aplikuese qe nuk jane shpallur fitues nga sistemi I pikezimit dhe qe do te trajtohen nepermjet perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar 6 % per ndihmen ekonomike
- Per heqjen e mandatit te keshilltares znj.Fatmire Kuli, anetare e Keshillit Bashkiak Kavaje, subjekti politik koalicioni "Bashke Fitojme" te dale nga zgjedhjet vendore te dates 14.05.2023
- Per nje ndrishum ne bendimin nr.79.date 19.12.2023 mbi miratimin buxhetor afatmesem 2024-2026 dhe buxhetin e Bashkise Kavaje per vitin 2024.
- Per miratimin e nivelit te pagave e te shperblimeve funksionareve te zgjedhur e te emeruar te nepunesve sivile,institucioneve ne varesi te njesive administrative.si dhe te punonjesve administrative dhe punonjesve mbeshtetes ne Bashkine Kavaje.
- Per heqjen e mandatit te Keshilltarit z.Baki Dervishi anetar I keshillit bashkiak Kavaje,subjekti politik koalicioni Bashke Fitojme.te dala nga zgjedhjet vendore te dates 14.5.2023.
- Zgjedhjet e strukturave komunitare ne fshatrat e njesive Adninistrative Golem.Synej.Helmes dhe Luzi I Vogel te Bashkise Kavaje.
- Per pranimin e personave ne nevoje ne Institucionin Shtepia e te Moshuarve "Sefer Dervishi"Kavaje
- Per dhenien e titullit "Qytetare Nderi"(pas vdekjes)znj.Mukades Gugashi.
- Per dhenien e titullit "Qytetare Nderi"(pas vdekjes)znj.Frida Arkaxhiu.
- ~~Dhenien e mandatit te Keshilltarit znj.Kledja Vishkulli.~~
- Shprehjen e pelqimit per miratimin e programit te punes per parandalimin dhe masat qe duhen marre per mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri per vitin 2024

- Per miratimin e linjave rrethqytetase te transportit te udhetareve brenda territorit te Bashkise Kavaje
- Per perdorimin e fondit per emergjencat civile. 1. Te miratoje dhenien e pelqimit te perdorimit te fondit te kushtezuar per emergjencat civile per blerje automjeti zjarrfikese, per perdorim te vecante per perballimin e situatave emergjente, sipas germes ë, te pikes 3.1 te VKM nr.414, date 08.07.2021, i ndryshuar.
- Mbi dhenien e mandatit te anetarit te Keshillit Bashkiak z.Enea Stefa
- Per miratimin e tavaneve te shpenzimeve buxhetore te programit buxhetor afatmesem 2025-2027
- Per miratimin e prokjekt-buxhetit afatmesem 2025-2027 per te ardhurat
- Per heqjen e mandatit te keshilltarit z. Parit Xhihani, anetar I Keshillit Bashkiak Kavaje, subjekt politik Partia Socialiste, te dala nga zgjedhjet vendore te dates 14.05.2023
- Per ngritjen e komisionit te integrimit ne BE, dhe marrdheniet me jashte te Keshillit Bashkiak Kavaje
- Per trajtimin me banese sociale te familjes se Ferid Llana, pa pagese qiraje per nje afat te pacaktuar deri ne permiresimin e kushteve ekonomike te familjes
- Per lirimin per shkak te doreheqjes se sekretarit te Keshillit bashkiak Kavaje
- Per emerimin e sekretarit te keshillit bashkiak Kavaje
- Per dhenie Titulli "Qytetar Nderi", per z. Tahir Okshtuni me motivacionin "Per kontributin e cmuar si anetar dhe drejtues per mbi 3 dekada I shoqates antikomuniste "26 Marsi"
- Per dhenien e mandatit anetarit Qerem Celpica
- Per dhenie Titulli "Qytetar Nderi", per z. Jorgji Tirana
- Per dhenie mandati anetarit te Keshillit Bashkiak Kavaje Enea Stefa
- Per miratimin e tavaneve te shpenzimeve buxhetore te programit buxhetor afatmesem 2025-2027
- Per miratimin e projekt buxhetit afatmesem 2025-2027 per te ardhurat
- Per pranimin e personave ne nevoje, ne Institucionin Shtepia e te Moshuarve "Sefer Dervishi" Kavaje, te qytetarit Gjinovefa Doja
- Per pranimin e personave ne nevoje, ne Institucionin Shtepia e te Moshuarve "Serfer Dervishi" Kavaje, per znj. Gjinovefa Theodhor Doja.
- Per dhenie titulli "Qytetar Nderi", z.Jorgji Tirana, me motivacionin "per kontributin e cmuar dhene si ish-trainer ne skuadren e ciklizmit "Besa" Kavaje dhe ekipin kombetar te moshave. Ka treguar pasion e aftesi spikatese dhe shfaqur vlera te vecanta me promovimin e ciklisteve kavajas dhe traditat pozitive te ketij sporti.
- Per lenie mandati anetarit z, Genci Gjylsheni
- Mbi miratimin e disa ndryshimeve ne VKB nr.4 date 20.01.2023
- Per miratimin e nivelit te pagave e te shperblimeve funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nenpunesve civile, institucioneve ne vartesi dhe te njesive administrative si dhe te punonjesve mbeshtetes ne Bashkine Kavaje
- Per miratimin e raportit te buxhetit per vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave per vitin 2025-2027

- Per miratimin ne parim te marrveshjes se Bashkise Kavaje dhe FSHF dhe miratimin e financimit te FSHF per ndertimin e Stadiumit Besa si dhe dhenien e autorizimit te krytarit te bashkise per nenshkrimin e saj
- Per nje ndryshim ne VKB nr.79, date 19.12.2023 "Per miratimin e programit buxhetor afatmesem 2024-2026 dhe buxhetit te vitit 2024"
- Per nje ndryshim ne VKB nr.79, date 19.12.2023 "Per miratimin e programit buxhetor afatmesem 2024-2026 dhe buxhetit te vitit 2024"
- Per miratimin e tavaneve te shpenzimeve buxhetore te programit buxhetor afatmesem 2025-2027
- Per rishperndarjen e fondeve buxhetore per zbatimin e VKM nr.503, date 01.08.2024 "Per rritjen e pagave te administrates se veteqeverisjes vendore"
- Per ndryshimin e emertimit te zerit buxhetor brenda programit
- Mbi propozimin e nxjerrjeve jashte perdorimit te materialeve te stadiumit "Klubit Sportiv Besa" te Bashkise Kavaje
- Per ndryshimin e emertimit te zerit buxhetor brenda programit
- Per dhenie titulli "Qytetar nderi" per At Petro Thanasi
- Miratimin e disa kundervajtjeve dhe sanksioneve qe vendoset per to ne territorin e bashkise Kavaje
- Per dhenien e ndihmes financiare per fatkeqesi familjare ne Njesine Administrative Helmes per Mirvana Idriz Kazazi
- Per miratimin e planit Social Vendor 2025 - 2028
- Per sistemin e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2025 ne Bashkine Kavaje
- Per dhenien e mandatit te anetarit te Keshillit Bashkiak Znj. Meleqe Kazazi
- Per miratimin e bursave per nxenesit e arsimit parauniversitar ne institucionet arsimore publike profesionale per vitin shkollor 2024-2025
- Per miratimin e financimit te qendrave shendetesore ne fshatin Peqinaj dhe Bukaq, si pjese e bashkefinancimit me shoqaten Gjysmehena e Kuqe e Emirateve te Bashkuara Arabe
- Per miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxhetit 2025

**Për periudhën janar – dhjetor 2024, janë marrë 69 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Kavajë.**
***(Bashkëngjitur materialit gjeni dosjen e vendimeve ku është përcaktuar saktë numri i vendimit, data e vendimit, data e shpalljes së vendimit, titulli i vendimit, data e miratimit nga Prefekti dhe nr.i fletëve të vendimit dhe dokumentave shoqëruese të tij, të cilat janë të publikuara dhe në faqen e internetit të Këshillit)***

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Kavajë kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2024 institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për 64 vendimet e marra, dhe nuk janë konfirmuar 4 prej tyre në gjysmën e dytë të vitit 2024.
Nga Prefektura Tiranë është kryer kontroll sipas legjislacionit dhe në raportin përfundimtar të datës 18.12.2024 është cilësuar se Këshilli Bashkiak Kavajë ka zbatuar me korrektësi

të gjitha detyrimet ligjore dhe rekomandon rishikimin e rregullores në lidhje me proçedurën on-line apo dhe problematika të tjera të hasura gjatë punës në vijim si dhe shtesë personeli në Sekretariatin e Këshillit për të bërë të mundur në këtë mënyrë zbatimin e rregulloreve që ka miratuar.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Kavajës.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë aktiv, duke mbajtur mbledhje të radhës, mbledhje jashtë radhe dhe mbledhje të jashtëzakondshme, sipas tabelës së mëposhtëme :

| Muaji | Nr i mbledhjeve | Mbledhje të radhës | Mbledhje jashtë radhe | Mbledhje të jashtëzakondshme |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 1 | 1 (29.01.2024) | | |
| Shkurt | 1 | 1 (27.02.2024) | | |
| Mars | 1 | 1 (26.03.2024) | | |
| Prill | 1 | 1 (26.04.2024) | | |
| Maj | 2 | 1 (17.05.2024) | 1 (28.05.2024) | |
| Qershor | 1 | 1 (28.06.2021) | | |
| **Total 6 mujor parë** | **7** | **6** | **1** | |
| Korrik | 2 | 1 (08.07.2024) | 1 (29.07.2024) | |
| Gusht | 1 | 1 (21.08.2024) | | |
| Shtator | 1 | 1 (30.09.2024) | | |
| Tetor | 1 | 1 (22.10.2024) | | |
| Nëntor | 1 | 1 (26.11.2024) | | |
| Dhjetor | 1 | 1 (23.12.2024) | | |
| **Total 6 mujor dytë** | **7** | **6** | **1** | |

| Periudha | Nr i mbledhjeve | Mbledhje të radhës | Mbledhje jashtë radhe | Mbledhje të jashtëzakondshme |
|---|---|---|---|---|
| 6 mujori parë | 7 | 6 | 1 | |
| 6 mujori dytë | 7 | 6 | 1 | |
| Total 12 mujori | 14 | 12 | 2 | |

*Kalendari i zhvillimit të mbledhjeve paraqitet si më poshtë :*

| **Nr.** | **DATA E MBLEDHJES** | **ORA** | **VENDI I ZHVILLIMIT** |
|---|---|---|---|
| 1. | 29.01.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 2. | 27.02.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 3. | 26.03.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 4. | 26.04.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 5. | 17.05.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| ~~6.~~ | ~~28.05.2024~~ | ~~11:00~~ | ~~Salla e keshillit bashkiak~~ |
| 7. | 27.06.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 8. | 08.07.2024 | 10:00 | Salla e keshillit bashkiak |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 9. | 29.07.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 10. | 21.08.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 11. | 30.09.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 12. | 22.10.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 13. | 26.11.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |
| 14. | 23.12.2024 | 11:00 | Salla e keshillit bashkiak |

Siç shihet dhe nga kalendari i mbledhjeve gjatë muajit janar-dhjetor 2024, Këshilli ka mbajtur senacën plenare në sallën e mbledhjeve te këshillit bashkiak.

Vlen për tu përmendur se pjesmarrja e këshilltarëve ka qënë më aktive në proçesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare online.

Komisionet e përhershme të këshillit nuk janë mbledhur conform rregullores për të diskutuar dhe miratuar projektvendimet e sjella nga administrata e Bashkisë Kavajë. Për periudhën 12-mujore janë bërë mbledhje të komisioneve të përhershëm,

| **Nr.** | **Muaji** | **Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm** |
|---|---|---|
| 1. | Janar | 2 |
| 2. | Shkurt | 2 |
| 3. | Mars | 2 |
| 4. | Prill | 1 |
| 5. | Maj | 1 |
| 6. | Qershor | 1 |
| | **Total 6 mujori I-rë** | **9** |
| 7. | Korrik | 1 |
| 8. | Gusht | 1 |
| 9 | Shtator | 2 |
| 10 | Tetor | 2 |
| 11 | Nëntor | 2 |
| 12 | Dhjetor | 2 |
| | **Total 6 mujori II-të** | **10** |
| | | |

Në çdo rast Komisionet e Përhershme në zbatim të "Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Kavajë" nuk kanë mbajtur raportin conform rregullores ku pasqyrohet vendimmarrja e secilit komision për pikat e rendit të ditës, që u janë caktuar për t'i shqyrtuar, sipas tabelës së mëposhtëme:

| ***Nr.*** | ***Komisioni*** | ***6 mujori parë 2024***<br>***RAPORTE E PROÇESVERBALE TË KOMISIONEVE*** |
|---|---|---|
| | | ***sipas pikave të rendit të ditës*** |

| | | *Janar* | *Shkurt* | *Mars* | *Prill* | *Maj* | *Qershor* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike | 2 | | | | | |
| 2. | Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës | | | | - | - | |
| 3. | Komisoni Mandateve | | - | - | - | 1 | - |
| 4. | Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike | | | | | | |
| 5. | Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave | - | 1 | | | | |
| 6. | Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë | - | | - | | | - |
| 7. | Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë,Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit | - | | | | | 1 |
| 8. | Komisioni i Mardhënieve me Jashtë | - | - | - | - | - | - |
| 9. | Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve | - | - | 1 | - | - | |
| 10. | Komisioni Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale | | | - | 2 | | |
| 11. | Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor | 1 | - | | | - | |
| 12. | Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik | - | - | | - | - | |
| 13. | Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit | - | - | | - | - | |
| 14. | Komisioni Etikës, Apelimeve, Konfliktit te Interesit, Peticioneve | - | - | - | - | - | - |
| | **Totali – 9** | **3** | **1** | **1** | **2** | **1** | **1** |

| Nr. | Komisioni | 6 mujori dytë 2024<br>RAPORTE E PROÇESVERBALE TË KOMISIONEVE<br>sipas pikave të rendit të ditës | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| 1. | Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike | | | 1 | | | |
| 2. | Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës | | | | | 1 | |
| 3. | Komisoni Mandateve | - | - | - | - | 1 | - |
| 4. | Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike | | | | | | |
| 5. | Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave- Tarifave | | | 1 | | 1 | 2 |
| 6. | Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe | - | - | - | | - | - |
| 7. | Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe | - | - | - | 1 | 1 | |
| 8. | Komisioni Mardhënieve me Jashtë | - | - | - | - | - | - |
| 9. | Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve | - | | - | - | - | - |
| 10 | Komisioni Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale | | | | | | |
| 11 | Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor | | | | -1 | - | |
| 12 | Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik | - | - | - | - | - | - |
| 13 | Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit | | - | - | - | - | - |
| 14. | Komisioni Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve | - | - | - | - | - | - |
| 15. | **Totali 6 mujori II–të 10 raporte** | **0** | **0** | **2** | **2** | **4** | **2** |

| **Nr.** | **Periudha** | **Raportet e Komisioneve të Përhershëm** |
|---|---|---|
| 1. | Totali 6 mujori I–rë | 9 |
| 2. | Totali 6 mujori II–të | 10 |
| | **Totali 12 mujor** | **19** |

*<u>Sqarim</u>: Lihet si detyrë fiunksionale për këshilltarët për tu mbledhur në komisione sipas*

*rregullores së funksionimit dhe organizimit të këshillit Bashkiak.*

**Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në:**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | për probleme financiare | - 25 vendime, |
| 2. | për probleme sociale | - 14 vendime, |
| 3. | për infrastrukturën dhe strehimin | - 4 vendime, |
| 4. | për problemet urbane dhe asetet | - 1 vendime, |
| 5. | për emergjencat civile | - 1 vendime, |
| 6. | për probleme të arsimit kulturës | - 2 vendime, |
| 7. | të ndryshme | - 22 vendime. |

**Vlen të përmendet fakti se gjatë këtij viti Këshilli Bashkiak miratoi plane si më poshtë:**
Per miratimin e planit Social Vendor 2025 - 2028

Mbetet për detyrë implementimi i tyre në praktikë dhe për të arritur sa më mirë këtë duhet bashkëpunimi i të gjithë hallkave (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet)

Me asistencë të Koordinatores së Projektit Bashki të Forta, është bërë nga e para faqa ëeb online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet kartelave të mëposhtëme:

*Rreth Këshillit Bashkiak Struktura e Këshillit Bashkiak Anëtarët e Këshillit Bashkiak Përbërja e Komisioneve Konferenca e Kryetarëve Legjislacioni*
*Rregulloret*
*Kalendari Mbledhjeve Të Këshillit Njoftime (KB)*
*Projekt-vendimet në proçes shqyrtimi nga KB Proçesverbalet e mbledhjeve të KB*
*Vendime të Këshillit Bashkiak Konsultimet Publike*
*Regjistri i projekt akteve për konsultim publik të këshillit bashkiak Raporte të Këshillit*
*Model formatesh për t'u shkarkuar nga komuniteti*
*Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare Dëgjesa Publike*
*Pyetësor për Buxhetin 2022-2024* etj.

Lind nevoja për bashkëpunim me të gjitha drejtoritë të cilat e kanë detyrim ligjor të plotësojnë materialet e nevojshme për tu hedhur online sipas kategorive të ndryshme.

Në vijim do të plotësohet faqa edhe për të gjitha materialet e file të këshillit bashkiak.

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit për njoftimet publike ( *si në faqen zyrtare të Bashkisë, në media vendore, me email drejtuar OJF, Drejtorëve të bashkisë, Kryetarëve të Njëisve Administrative, në këndin e informacionit në zyrën e mardhënieve me publikun në Bashkinë Kavajë*) në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Kavajë.

Në zbatim të rregullores ankesave/kërkesave dhe i iniciativave/peticioneve është vënë në funksionim regjistri elektronik dhe fizik i ankesave/kërkesave dhe i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit. Forma e komunikimit ka qenë me email ose me postë.

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përçimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët ka hapur faqen e tij në rrjetin social facebook në të cilin bën njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjerime nga qytetarë të ndryshëm. Të gjitha mbledhjet plenare të këshillit janë transmetuar direkt dhe nëpërmjet këtij rrjeti, ku komuniteti ka ndjekur direkt mbledhjen dhe ka dhënë mendimet për çështjet që janë shqyrtuar.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës në fund të çdo mbledhje është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit u 2 paraqitën në këshill "Raporte të Bashkisë Kavajë". Do ishte e nevojshme një bashkëpunim dhe një angazhim më i madh për ekzekutivin që të pregatisë në kohë raportet dhe informacionet e planifikuara për vitin 2024, por edhe për rastet kur do të kërkohen nga këshilli.

Këshilli Bashkiak ka patur në buxhetin e tij të miratuar për vitin 2024 vlerën prej 800.000 lekë sipas planit bashkëlidhur dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak, nr.69, datë 23.12.2024.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014 "Për konsultimin publik" gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, këshilli në bashkëpunim me bashkinë ka mundur të zhvilloj 5 dëgjesa publike, lidhur me miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 si dhe projekt buxhetin e vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Kavajë, në të cilat janë bërë pjesë diskutimi qytetarët e të gjithë njësive administrative si dhe grupe interesi, ku morën pjesë 100 banorë. Vlen të përmendet fakti se pjesa më e madhe e propozimeve nga komuniteti u reflektuan në buxhetin e Bashkisë Kavajë për vitin 2025.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Punë të mbarë për vitin 2025 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

Falenderimet gjithashtu shkojnë për....

- Falenderojmë për punën e palodhur administratën e Bashkisë Kavajë dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretariatit të Këshillit dhe në veçanti Drejtorinë Juridike, Kabinetin e Kryetarit, Drejtorinë Ekonomike, Komisionet apo Zyrën e Rindërtimit, Protokollin dhe Zyrën e Marrdhënieve me Publikun.
- Falenderojmë znj.Eneida Marku koordinatore e projektit "Bashki të Forta" për asistencën teknike dhe operacionale.

---

Meri Biturku